



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1579/Prot
5

Tiranë, më 15/01/2014

Lënda: Urdhër për Kontrolluesin “Kastrati Group”, Durrës.

U R D H Ë R

Nr. 02, datë 15/01/2014

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe nr. 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit “Kastrati Group”, Durrës.

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr. 228, datë 07.11.2013, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit “Kastrati Group”, me adresë, Ura e Dajlanit, Autostrada Durrës-Tiranë, KM 1, Durrës. Ky kontroll administrativ u fillua kryesisht nga Komisioneri.

Objekti i Kontrollit administrativ ishte:

- Plotësimi i detyrimit për njoftim (neni 21).
- Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale të përpunuara në kuadër të kartave elektronike të klientëve (nenet 5-9 dhe 12-16).
- Masat lidhur me sigurinë e të dhënave personale dhe ruajtja e konfidencialitetit (neni 27 dhe 28).

Nga kontrolli administrativ i zhvilluar, rezulton se kontrolluesi “Kastrati Group” gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij privat në fushën e tregtimit me shumicë dhe pakicë të karburanteve, mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë “klientë”.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ, pretendimet e kontrolluesit, si dhe provat e administruara vëren se:

- Paraprakisht u konstatua se Kontrolluesi **“Kastrati Group”**, nuk e kishte realizuar detyrimin për njoftim pranë Autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar. Në këtë kuadër, në procesverbalin e kontrollit iu la si detyrë që të kryejë njoftimin. Në vazhdim, pas verifikimit në regjistër, konstatohet se kontrolluesi e ka realizuar detyrimin për njoftim pranë Autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në këtë kuadër, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson angazhimin e kontrolluesit **“Kastrati Group”**, për realizimin e detyrimit për njoftim brenda afatit të përcaktuar në procesverbalin e kontrollit administrativ, në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar.
- Në kuadër të zbatimit të shkronjës c), të pikës 1, të nenit 5 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar, lidhur me respektimin e parimit të mjaftueshmërisë dhe proporcionalitetit në përpunimin e të dhënave personale të klientëve, Komisioneri vlerëson se përpunimi i të dhënave të tilla si *datëlindja, profesioni, dhe adresa e banimit ose punës (lagja dhe rruga)* është në tejkalim të qëllimit i cili ka të bëjë thjesht me ofrimin e shërbimit të pajisjes së klientit me kartën elektronike (*“Kartën Bonus”* dhe/ose *“Tollonin Elektronik”*). Pra këto të dhëna janë të tepërta dhe si të tilla nuk duhet të përpunohen më.
- Të dhënat personale të klientëve mbahen në formularët e aplikimit dhe në sistem për një afat të pacaktuar. Në pjesën mbrapa formularit të aplikimit ku parashikohen *“Kushtet e përgjithshme të përdorimit të tollonit elektronik”*, në pikën 24 parashikohet se tolloni elektronik është lëshuar për një periudhë të pacaktuar kohe dhe mbajtësi i tij mund ta anulojë atë me shkrim në çdo kohë, pa përmendur ndonjë shkak. Por nuk parashikohet se çfarë ndodh me të dhënat personale të klientit të administruara në formularin e aplikimit, që ruhet në dollap me çelës, dhe në sistemin elektronik. Pra, nuk parashikohet nëse të dhënat fshihen apo jo.
- Komisioneri vlerëson se në këtë rast të dhënat mbahen më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar. Në këtë kuadër, kontrolluesi duhet të përcaktojë afate konkrete sa i përket mbajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale:
 - a) të personave që kanë bërë aplikimin për kartë por nuk e kanë tërhequr atë;
 - b) të klientëve, që u kanë mbaruar kreditet në *“Tollonin elektronik”* dhe nuk e kanë rimbushur më kartën për një afat të caktuar;
 - c) të klientëve, që i kanë përdorur litrat e karburantit të përfituara si bonus, dhe nuk e kanë përdorur më *“Kartën Bonus”* për një afat të caktuar.

Vendosja e këtyre afateve është e domosdoshme pasi të dhënat e klientëve nuk mund të mbahen për një afat të pacaktuar duke përbërë rrezik për cënimin e privatësisë së tyre. Komisioneri vlerëson dhe gjykon se afatet duhet të përcaktohen në përputhje me qëllimin e veprimtarisë së kontrolluesit. Vendosja e këtyre afateve ka si qëllim zbatimin e parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale dhe shkronjës d), të pikës 1, të nenit 5 të ligjit. Për këto afate bazuar në nenin 18 të ligjit duhet të informohet çdo klient. Informimi mbi afatet dhe pëlqimi i klientit duhet të parashikohet në Formularin e aplikimit, në mënyrë që procesi të jetë sa më transparent dhe klienti të jetë sa më i informuar me qëllim që pëlqimi të jetë i plotë dhe lehtësisht i shprehur.

Për mbajtjen e të dhënave personale të klientëve për një afat më të gjatë duhet të merret pëlqimi i informuar paraprak i klientit (në formë shkresore).

- Në kuadër të zbatimit të nenit 6, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, pëlqimi i klientit merret në formë shkresore, nëpërmjet plotësimit dhe nënshkrimit të formularit të aplikimit për kartë. Në pjesën mbrapa formularit të aplikimit ku parashikohen "*Kushtet e përgjithshme të përdorimit të tollonit elektronik*", në pikën 14 parashikohet se: "Me plotësimin dhe firmosjen e formularit të aplikimit, mbajtësi i tollonit elektronik i lejon lëshuesit, si operator i mbledhjes së të dhënave personale, të përpunojë informacionin personal të dorëzuar nga përdoruesi si dhe të gjithë informacionin e marrë në lidhje me përmbajtjen e blerjeve".
- Në pjesën e pasme të formularit të aplikimit parashikohen dispozita mbi mbrojtjen e të dhënave personale. Në këto dispozita, ndër të tjera, parashikohet fusha dhe qëllimet për të cilat do përdoren të dhënat personale të klientit, mënyra e përpunimit, si dhe të drejtat që gëzojnë për të dhënat e tyre. Në këtë kuadër komisioneri vlerëson se kemi zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar.
- Kontrolluesi në faqen zyrtare në internet nuk ka të publikuar "politikat e privatësisë", që janë një paketë rregullash (referuar Ligjit nr. 9887, të ndryshuar) të cilat kanë si qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen (të cilët mund të jenë edhe klientë) mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave (klientë) dhe detyrimet e kontrolluesit ("**Kastrati Group**"). Komisioneri vlerëson se politikat e privatësisë janë shumë të rëndësishme pasi ndikojnë në sensibilizimin e publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzojnë në këtë fushë.
- Në kuadër të mbrojtjes së sigurisë së të dhënave personale të klientëve dhe ruajtjen e konfidencialitetit (neni 27, 28), Komisioneri konstaton se:
 - 1) Formularët e aplikimit ruhen në ambiente të sigurta dhe dollapë metalike të siguruara me çelës. Aksesit në to është i kufizuar vetëm për disa persona. Ndërsa aksesit në sistemin elektronik është i kufizuar vetëm për dy specialistët IT dhe dy përdorues të tjerë të cilët hedhin të dhënat personale në sistem. Përdoruesit e sistemit janë të pajisur me "emër përdoruesi" dhe "fjalëkalimin" përkatës në mënyrë të personalizuar, dhe çdo veprim në sistem lë gjurmë.
 - 2) Në pjesën e pasme të formularit të aplikimit ku parashikohen "*Kushtet e përgjithshme të përdorimit të tollonit elektronik*", në pikën 14 parashikohet se: "Kastrati garanton se informacioni personal i mbajtësit të tollonit elektronik dhe të gjitha informacionet e tjera të mbledhura, janë të mbrojtura nga zbulime të paautorizuara dhe komunikimeve me palë të treta të paautorizuara. Gjithë informacioni personal në lidhje me mbajtësin e tollonit elektronik është konfidencial".
 - 3) Personat që kanë akses në të dhënat personale të klientëve të administruara nëpërmjet formularëve të aplikimit dhe sistemit elektronik, nuk kanë nënshkruar një deklaratë konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave personale.

- 4) Kontrolluesi nuk ka një rregullore të brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara për qëllime të ushtrimit të aktivitetit.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

U R D H E R O J

1. Kontrolluesi “**Kastrati Group**”, në zbatim të shkronjës c) të nenit 5 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, nuk duhet të mbledhë dhe të përpunojë të dhënat e klientëve mbi *datëlindjen, profesionin, dhe adresën e banimit ose punës (lagja dhe rruga)*. Të dhënat që janë mbledhur deri në ditën e marrjes dijeni të këtij urdhëri të fshihen nga formularët e aplikimit dhe sistemi, pasi janë të tepërta dhe në tejkalim të qëllimit të përpunimit për të cilin ato mblidhen, duke hartuar një formular të ri.
2. Kontrolluesi “**Kastrati Group**”, në zbatim të shkronjës d) të nenit 5 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të përcaktojë afate konkrete sa i përket mbajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale:
 - a) të personave që kanë bërë aplikimin për kartë por nuk e kanë tërhequr atë për një afat të caktuar;
 - b) të klientëve, që u kanë mbaruar kreditet në “Tollonin elektronik” dhe nuk e kanë rimbushur më kartën për një afat të caktuar (mbetet të përcaktohet nga kontrolluesi);
 - c) të klientëve, që i kanë përdorur litrat e karburantit të përfituara si bonus, dhe nuk e kanë përdorur më “Kartën Bonus” për një afat të caktuar (mbetet të përcaktohet nga kontrolluesi).
3. Kontrolluesi “**Kastrati Group**”, bazuar në Nenin 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, duhet që:
 - a) Të informojë paraprakisht çdo klient për afatet e vendosura;
 - b) Të marrë pëlqimin paraprak të klientëve (në formë shkresore) nëse synon të mbajë të dhënat personale të tyre, për një afat më të gjatë;
 - c) Informimin mbi afatet dhe pëlqimin e klientit ta parashikojë në Formularin e aplikimit.
4. Në zbatim të nenit 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar:
 - Personat që kanë akses në të dhënat personale të klientëve, të administruara nëpërmjet formularëve të aplikimit dhe sistemit elektronik, të nënshkruajnë një deklaratë konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave personale.
 - Të hartohet një rregullore të brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara për qëllime të ushtrimit të aktivitetit (referuar Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, të ndryshuar). Në të duhet të parashikohen masa konkrete sigurie,

detyrimet e kontrolluesit dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave. (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë).

5. Kontrolluesi **“Kastrati Group”**, në faqen zyrtare në internet duhet të publikojë “politikat e privatësisë” (paketë rregullash) me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave (klientë) dhe detyrimet e tij si kontrollues. Politikat e privatësisë synojnë sensibilizimin e publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzojnë në këtë fushë.
6. Këto detyrime të rëndësishme që ju ngarkon ligji, të kryhen brenda një afati kohor prej 40 (dyzetë) ditësh, nga dita e marrjes dijeni për këtë urdhër;
7. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
8. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit: “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

